



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°4/2021

Hagë, 07/10/2021

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë informacion përmbledhës të përditësuar mbi proceset gjyqësore dhe veprimtaritë e Gjykatës, si dhe informacion për javën e ardhshme.

Si gjithmonë mirëpresim çdo pyetje që mund të keni në fund të seancës informuese dhe do të përpiqemi t'ju përgjigjemi sa më mirë që të mundemi.

Të premtën e shkuar, Paneli i Gjykatës së Apelit vendosi lidhur me apelet e Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, kundër vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake për mbajtjen e tyre të mëtejshme në paraburgim.

Paneli i Gjykatës së Apelit miratoi një nga arsyet për apel të ngritura nga të akuzuarit dhe ia ktheu çështjen Gjykatës të Procedurës Paraprake për të vlerësuar më tej nëse ekzistojnë masa për të pakësuar rreziqet që vijnë nga lirimi i mundshëm i të akuzuarve dhe të cilat mund të zbatohen në mënyrë të efektshme nga policia e Kosovës.

Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë të gjitha arsyet e tjera për apel të ngritura nga të akuzuarit.

Të hënën dhe të martën e kësaj jave dha dëshminë e tij dëshmitari i tretë i Prokurorisë në gjykimin e Salih Mustafës. Dëshmitari dha prova për krimet që pretendohet se janë kryer në Zllash në muajin prill 1999.

Në fillim dëshmitarit i bëri pyetje Zyra e Prokurorit të Specializuar, pastaj mbrojtësja e viktimave dhe më pas avokati që përfaqëson z. Sali Mustafa. Gjithashtu, dëshmitarit i bënë pyetje edhe gjykatësit e Trupit Gjyqësor.





**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°4/2021

Hagë, 07/10/2021

Ditën e martën, më 12 tetor, është planifikuar që të fillojë me dhënien e dëshmisë dëshmitari i katërt në çështjen gjyqësore kundër z. Mustafa. Seanca fillon në orën 9:30 dhe do të transmetohet me 45 minuta vonesë.

Sot paradite filloi gjykimi i dytë i Dhomave të Specializuara të Kosovës për çështjen gjyqësore kundër z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj.

Për të akuzuarit janë ngritur dy akuza për vepra penale kundër rendit publik dhe katër akuza për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Në seancën e sotme, Prokurori i Specializuar dhe prokurorë të tjerë nga zyra e tij bënë deklaratën hyrëse ku shpjeguan cilat janë akuzat e ngritura ndaj të akuzuarve dhe çfarë synon të provojë ZPS-ja deri në fund të paraqitjes së provave të veta.

Paraqitja e provave prej Prokurorisë do të fillojë më 18 tetor dhe ajo synon të thërrasë tre dëshmitarë. Trupi Gjykues ka caktuar datën 9 nëntor si afat të synuar për përfundimin e paraqitjes së provave prej Prokurorit të Specializuar.

Në qoftë se Mbrojtja vendos të paraqesë prova, përfshirë edhe thirrjen e dëshmitarëve, atëherë kjo duhet të kryhet pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorisë.

Trupi Gjykues ka caktuar datën 17 dhjetor si afat të synuar për mbylljen e të gjithë çështjes gjyqësore.

Faleminderit.

Pyetje nga gazetarët

Nuk kishte pyetje.

